



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.231/2 prot.,

Datë 07.02.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Objekt: Anullimi i procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18- 2023 me objekt: Loti 5 “Blerje bojë, materiale, etj ”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane.*

Ankimues: Operatori Ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK.
Adresa: Rruga e Kavajës, Kompleksi Delijorgji, Përballë Rogat Security, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë
Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë

Në datën 06.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 231 prot., datë 06.02.2023 e operatorit ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18- 2023 me objekt: Loti 5 “Blerje boje, materiale, etj ”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane..*

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me pretendimin e operatorit ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK mbi procesin e administrimit të mostrave bazuar në pikën 1.3.3 si dhe anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë objektin e pretendimeve që operatori ekonomik ankimes “GENERAL PLUS” SHPK parashtron në ankesën me nr. 231 prot., datë 06.02.2023

Konkretisht objekti i pretendimeve në ankesën është si më poshtë vijon:

Procesi i administrimit të mostrave sipas kriterit 1.3.3:

“1.3.3. Për artikujt e kërkuar që paraqiten me shenjën asterisko () në Shtojcën 5 të DST, duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me datë 30.01.2023, në orën 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në Sekretarinë e SU “Shefqet Ndroqi”, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

- *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para dates __.__.2023, ora 10:00.*
- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht automatikisht do të skualifikohet.”

Si dhe:

“Anullimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18-2023 me objekt: Loti 5 “Blerje boje, materiale, etj”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 07.02.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri